



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada – Government**  
**Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë**  
**Ministarstvo za Inovacije i Prudetzništvo**  
**Ministry of Innovation and Entrepreneurship**

**Raporti 100 ditore i punës së Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë**

Në vijim të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës për mandatin Qeverisë 2017-2021, është themeluar Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë ka për synim stimulimin e aktiviteteve inovative në Republikën e Kosovës, të lidhura ngushtë me ndërmarrësinë dhe fushat tjera të ekonomisë, fuqizimin e sektorit privat. Fuqizimi i Ndërmarrësisë dhe Inovacionit do të realizohet përmes objektivave si: promovimi i inovacionit sipas sektorëve të ekonomisë në shërbim të rritjes ekonomike dhe zhvillimit, krijimi i mekanizmave institucional koordinues në mes të shkencës, sektorit privat dhe politikë-bërjes, zhvillimi i ndërmarrësisë përmes programeve të trajnimit, krijimi i fondeve për përkrahje të sektorëve zhvillimor me fokus tek gratë dhe të rinjtë si dhe mbështetja e zhvillimit të NVM-ve për ballafaqim me konkurrencën rajonale, atë të BE si dhe tregjet e tjera. Politikat ekonomike do të orientojnë dhe përkrahin ndërmarrjet të kombinojnë njohuritë, kapacitetet, aftësitë dhe resurset (njohuri për prodhimin, aftësi dhe hapsira, njohuri lidhur me tregun, sistem efikas të distribuimit, resurse të mjaftueshme financiare) për të zhvilluar konceptin e inovacionit brenda ndërmarrjes.

Me qëllim të arritjes së objektivave të MIN të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në fuqizimin e rolit të sektorit privat janë zhvilluar këto aktivitete:

- **Konstituimi i Ministrisë** - definimi i kompetencave, hartimi i rregullores së brendshme, përpilimi i draft-Buxhetit të Ministrisë për vitet 2017 dhe 2018.
- **Hartimi i programit të Ministrisë për vitet 2017-2021** – sipas të cilit do të bëhet promovimi i inovacionit sipas sektorëve të ekonomisë në shërbim të rritjes ekonomike

dhe zhvillimit, krijimi i mekanizmave institucional koordinues në mes të shkencës, sektorit privat dhe politikë-bërjes, zhvillimi i ndërmarrësisë përmes programeve të trajnimit, krijimi i fondeve për përkrahje të sektorëve zhvillimor me fokus tek gratë dhe të rinjtë si dhe mbështetja e zhvillimit të NVM-ve për ballafaqim me konkurrencën rajonale, atë të BE si dhe tregjet e tjera.

- **Themelimi i Këshillit Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi** - i cili ka rol këshillues për fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë. Këshilli për Inovacion dhe Ndërmarrësi kontribon në harmonizimin e politikave qeveritare dhe prioritet e sektorit privat.
- **Inicimi i themelimit të Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë** - në parkun e biznesit në Prizren, përmes Marreveshjes bilaterale financiare me Republikës Federale të Gjermanisë, e cila kontribuon në përgatitjen e startup-eve që nga faza e para inkubimit, inkubimit dhe deri në fazën e operimit në treg.
- **Inicimi i themelimit të Qendrave të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë nëpër disa qytete të Republikës së Kosovës, si dhe mbështetje për Start-UP** - përmes fondeve IPA 2019.

#### Aktivitete të tjera:

- Analizimi i përvojave të vendeve të rajonit dhe më gjerë për mënyrën e trajtimit/zhvillimit të fushës së inovacionit;
- Mbështetja e organizimit “Java Globale e Ndërmarrësisë”;
- Takime të shumta me donatorë potencial dhe dakordimi për bashkëpunim përmes mbështetjes financiare dhe ekspertizave;
- Vizita të ndryshme në terren me qëllim të identifikimit të kërkesave dhe nevojave të NVM-ve dhe qendrave egzistuese të Inovacionit ;

- Shkëmbimi i përvojave me njohës të fushës së inovacionit nga ata vendorë dhe ndërkombetarë;
- Takime të shumta me inovatorë potencial;